



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 26

Tiranë – E hënë, 27 shtator 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve nr. 63/2, datë 24.9.2021	Për marrjen e ambienteve me qira për zyra për stafin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve..... 3
Njoftim i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 6619, datë 24.9.2021	Për shpalljen e një vendi vakant për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit..... 4

**KËRKESË**

Nr. 63/2, datë 24.9.2021

**PËR MARRJEN E AMBIENTEVE ME
QIRA PËR ZYRA PËR STAFIN E
QENDRËS SË PARANDALIMIT TË
KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË
RINJVE**

I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit:

1. Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës së vërtetuar me certifikatë pronësie.

2. Vërtetim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim tjetër ligjor.

3. Vërtetim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.

4. Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.

5. Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

a) vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;

b) vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga *e-Sigurime*;

c) ekstrakt QKR-je që vërteton se ka status aktiv.

6. Vetëdeklarim që ofertuesi nuk është në konflikt interesi me Qendrën e Parandalimit të Krimeve të Të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR).

7. Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.

8. Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve në muaj (veç kërkesave të tjera, oferta të jetë e nënshkruar nga administratori ose pronari i ambientit dhe të përmbajë të dhënat, sipas tabelës më poshtë).

Nr.	Emri dhe NIPT-i i subjektit	Përshkrimi	Sasi	Sip. totale në m ²	Çmimi me TVSH
1		Ambient me qira			

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrjeje

1. Sipërfaqja e ambientit

Duke vlerësuar akomodimin e 16 punonjësve, si dhe planifikimin, për:

- **ambiente të magazinës** (sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”);

- **arkivit** (sipas kreut II-G të Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë – *sekretaria dhe arkivi apo sekretari-arkivi i subjektit shtetëror apo joshetëror vendosen në lokale të përshtatshme, që plotësojnë kërkesat e teknologjisë së ruajtjes së dokumenteve. Ato pajisen me mjetet mbrojtëse nga zjarri, nga rrezet e diellit, pluhuri dhe nga dëmtuesit e tjerë fizikë e biologjikë*).

Përsa i përket sipërfaqes së ambientit, duhet të plotësojë këto kritere:

Sipërfaqja totale e ambientit të punës duhet të variojë nga 200 m² deri në 250 m², ku duhet të përfshijë të paktën **9 zyra**, si dhe **2 tualete** (të kompletuara me pajisjet hidrosnaitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë).

2. Godina duhet të jetë e ndërtuar konform standardeve të ndërtimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Zyrat të kenë ndriçim natyral, si dhe sistem kondicionimi, dritare në çdo zyrë, ambiente pa lagështi dhe mundësisht në katet e para deri të dyta të ndërtesave për të qenë lehtësisht të aksesueshme.

3. Ndriçimi duhet të jetë i konceptuar, i realizuar, si dhe të mirëmbahet në mënyrë që të mënjanojë çdo lodhje të shikimit.

4. Mjedisi duhet të jetë patjetër i pajisur:

- me sistem të fikjes së zjarrit (kryesisht magazina dhe arkivi), fikës zjarri në sasi të mjaftueshme, të cilët duhet të jenë në gjendje të mirë funksionimi, bazuar në legjislacionin në fuqi;

- me sistem hidraulik dhe elektrik të përshtatshëm për ambiente zyre;

- objekti duhet të ketë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jetë i pajisur me matësit e ujit dhe të energjisë elektrike;

- objekti/ambientet duhet të kenë rrjet interneti të instaluar, si dhe rrjetin e prizave;

- me sistem ngrohje/ftohje;

5. Objekti duhet të jetë i përfunduar me dyer, dritare, i lyster dhe i gatshëm/i lirë për t’u shfrytëzuar nga qiramarrësi.

6. Ambientet duhet të jenë bosh dhe të lira; dorëzimi i objektit të bëhet brenda 5 ditëve pune nga njoftimi për lidhje kontrate.

7. Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj,



duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Pagesa e qirasë do të bëhet çdo muaj, në lek, brenda datës që palët do të bien dakord në kontratën me shkrim.

9. Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

10. Vendndodhja:

Duke u bazuar në misionin e Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve (QPKMR), nevojitet një ambient pune me vendndodhje gjeografike pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit të Provës, në kushtet kur detyrat institucionale të Qendrës janë të lidhura ngushtësisht me këto institucione.

III. Paraqitja e dokumenteve dhe ofertës së qirasë së ambienteve

1. Dorëzimi i dokumenteve dhe i ofertave ekonomike duhet të bëhet brenda datës **8 tetor 2021, ora 12:00**. Dokumentet të dorëzohen të skanuara në adresën elektronike të institucionit: qpkmr@drejtesia.gov.al dhe dorazi, pranë zyrës së protokollit të institucionit të Qendrës së Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, në adresën: Ministria e Drejtësisë, bulevardi “Zogu I”.

2. Për çdo komunikim apo sqarim, lutemi na shkruani në adresën elektronike: qpkmr@drejtesia.gov.al ose kontaktoni Koordinatorin për të Drejtën e Informimit të QPKMR-së, në numrin cel.: 0696128782.

NJOFTIM

Nr. 6619, datë 24.9.2021

PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Këshilltarit Ligjor në Komisionin e

Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: 80% e G3.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi me diplomë “Master i shkencave” në Shqipëri ose studimet universitare për drejtësi jashtë vendit dhe ka marrë diplomë të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për njësimin e diplomave;

b) të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze;

c) të ketë shtatë vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë ose në administratën publike.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015.

- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale.

- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit.

- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;

2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;

3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune (origjinale ose të noterizuara));

4. Dëshmi penaliteti;

5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës **7 tetor 2021**, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–premtë, ora 8:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2021